



REPUBLIKA E KOSOVËS/ RE
PUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



THIRRJE PUBLIKE

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE TË ORGANIZATAVE JO-QEVERITARE TË KOMUNITETEVE

Gjakovë, 09.08.2022

1. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare që vijnë nga radhët e komuniteteve joshumicë (Romë, Ashkali dhe Egjiptian) të Regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e sektorit të komuniteteve pakicë, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribojnë në zbatimin e programit të ZKKK-së në Komunës së Gjakovës që i dedikohet promovimit të komuniteteve.

2. OJQ-të e komuniteteve në përputhje me këtë thirrje mund të aplikojnë me projekte për fushat e tyre prioritare si në vijim:

1. E drejta e informimit për komunitete dhe qasja në media (radio dhe tv elektronike, online etj);
2. Organizimi i trajnimeve për të rinjtë lidhur me aftësimin e shkathtësive të buta si dhe punësimin (sit ë themelohet një plan biznesi);

3. Organizatat jo- qeveritare të udhëhequra nga komunitetet pakicë në komunën e Gjakovës mund të aplikojnë me projekte që kontribojnë në zbatimin e aktiviteteve në fushën e komuniteteve përmes aktiviteteve si më poshtë:

1. Aktivitetet që kanë për qëllim promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve;
2. Aktivitetet në fushën e medias që kanë për qëllim informimin e drejtë të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, promovimin e kulturës së tyre si dhe debate që i kontribojnë shoqërisë e në veçanti dialogut ndëretnik;
3. Aktivitete që i kontribojnë aftësimin dhe punësimin tek të rinjtë e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian duke i dhënë përparsi aktiviteteve innovative;

4. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për projekt individual është 300.00 Euro.

5. Afati për dorëzimin e propozimeve është jo më pak se 15 ditë, duke filluar nga data 08.08.2022 deri me datën: 26.08.2022.

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumeti me dy (2) projekte në kuadër të kësaj thirrje, por vetëm një (1) projekt për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është deri në fund të vitit 2022. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joQeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku 1 vit para datës së publikimit të thirrjes publike.

OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes fiannciare publike.

7. Së bashku me aplikacionin OJQ-të janë të obliguara të paraqesin dëshminë e Vërtetimit Tatimor të ATK-së dhe Vërtetimin e Gjkatës Ekonomike të OJQ-së.

8. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Gjakovës, në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim (ëeb faqja: ëëë.kk.rks-gov.net/gjakove/).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën: Rr. UÇK-së p.n. 50.000 Gjakovë, Republika e Kosovës/në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në ZKKK.

Armend Behluli
Udhëheqës i Sektorit në ZKKK

